



## Endoskopia e stomakut – gastroskopia

Endoskopia e stomakut, ndër të tjera, shfaqet me djegie të stomakut, dhimbje të paqarta në zonën e stomakut dhe në pjesën e sipërme të barkut, vështirësi në gjëllitje, ndjesi e trupave të huaj, si dhe anemi dhe mungesë hekuri. Gjithashtu mund të sqarohet dyshimi për një shqetësim stomaku dhe në zorrën dymbëdhjetëgjishtore. Në rastin e anamnezës familjare të trashëguar (kancer) është me vend të bëhet një ekzaminim parandalues.

Gjatë endoskopisë së stomakut bëhet ekzaminimi i saktë i membranës mukoze nga ezofagu, stomaku dhe dymbëdhjetëgjishtorja nëpërmjet një gastroskopie. Nëse nevojitet, nga seksionet përkatëse mund të merren, pa dhimbje, kampionë të membranës mukoze. Edhe polipet largohen gjithashtu pa dhimbje. Në fund, të gjithë kampionët dërgohen për t'u vlerësuar në një laborator të posaçëm

### Përgatitja për endoskopinë e stomakut

Deri gjashtë orë para ekzaminimit ju lejohet të hani diçka të vogël, d.m.th., jo ushqime që treten me vështirësi, apo me përmbajtje yndyrore. Deri tre orë para ekzaminimit lejohet edhe një gotë çaj ose ujë. Nuk duhet të pini më duhan, të mos merrni medikamente për lëngun gastrik dhe të mos përtypni çamçakëz.

### Ecuria e endoskopisë së stomakut

Në ditën e ekzaminimit ju presim në klinikën tonë në orarin e caktuar. Ecuritë tona i planifikojmë në mënyrë të tillë që, brenda mundësive, të mos ketë kohë pritjeje. Gjatë bisedës paraprake, mjeku shpjegon plotësisht së bashku me

ju gjendjen e shqetësimeve dhe u përgjigjet pyetjeve të mundshme ose pasigurive nga ana Juaj. Për ta ndërtuar ekzaminimin në mënyrën sa më komode të mundshme, ju jepet një medikament qetësues (hapje gjumi), i cili garanton heqjen e dhimbjeve dhe një ecuri pa probleme.

Vetë ekzaminimi zgjat vetëm rreth 15 minuta. Në fund të tij bëhet sërish një bisedë me mjekun, i cili ju sqaron rezultatet dhe ju përgjigjet pyetjeve tuaja.

## Pas ekzaminimit

Do t'ju luteshim që të mos vini me makinë në këtë takim ose t'ju shoqërojë dikush; medikamentet që ju kemi rekomanduar çënojnë aftësinë për të drejtuar makinën.

Menjëherë pas ekzaminimit ju mund të hani dhe të pini sërish si zakonisht, nëse mjeku nuk ju përshkruan diçka tjetër.

Rezultatet e ekzaminimit ju bëhen të ditura menjëherë pas përfundimit të tij. Vlerësimi i shumicës së kampionëve të marrë të indeve zgjat dy deri në tri ditë. Nëse do të shfaqeshin anomalitë, do të informoheni. Në çdo rast, mjekut të familjes i dërgohet një raport.

